



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:900218
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05628910

Cap.nr.1658/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Farmaceutik, kundër debitorës I.M., Kryeinferimere e Repartit të Nefrologjisë-SHSKUK-QKUK me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Skender Musa avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të debitorës, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.277/20 të datës 12.01.2021, jashtë seance me datë 26.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit së debitorës I.M., Kryeinferimere e Repartit të Nefrologjisë-SHSKUK-QKUK me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.277/20 të datës 12.01.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr. 277/20 të datës 12.01.2021, në dispozitiv e ka refuzuar prapësimin e debitorës I.M., Kryeinferimere e Repartit të Nefrologjisë-SHSKUK-QKUK me seli në Prishtinë, për borxh, i paraqitur kundër urdhrin përmbartues P.nr.708/2023 datë 19.09.2019, i caktuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i debitorës, pa cakur në veçanti shkaqet e ankimit, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi i atakuar me të cilin është refuzuar prapësimi i debitorës dhe ka lënë të lejuar urdhrin e lejuar nga përmbartuesi privat Afet Mjeku P.nr.708/19 të datës 19.09.2019, i cili është i pabazuar dhe i paligjshëm.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues–Vendimit të Inspektoratit Farmaceutik Nr.10/LB-017-18 të datës 27.08.2020, për gjobën e shqiptuar në shumë prej 1,000.00 €. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin e kërkuar nga kreditori me urdhrin P.nr.708/23 të datës 19.09.2019, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 28.10.2019. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimin të debitorit vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, organi përmbartues e cakton përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit përmbartues që ka titull përmbartues, organi përmbartues e cakton përmbartimin vetëm në bazë të titullit përmbartues sipas dispozitë së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, si dokument përmbartues është: *“vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”*. Në rastin konkret titull përmbartues është Vendimit të Inspektoratit Farmaceutik Nr.10/LB-017-18 të datës 27.08.2020, i plotfuqishëm nga data 02.09.2019 dhe i ekzekutueshëm nga data 11.09.2019. Dokument përmbartues në bazë të nenit 23 paragrafi 2, të LPP-së është përcaktuar se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet aktvendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse ujdia administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”*, dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me vendim siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, prandaj për shkak të zbatimit të

rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorës se gjykata nuk ka zbatuar dispozitën e nenit 319 të LPK-së, lidhur me provimin e fakteve mbi të cilat është bazuar propozimi dhe se gjykata nuk i ka vlerësuar të gjitha faktet drejtë me rastin e vendosjes. Në rastin konkret në procedurën përmbartimore gjykata lidhur me prapësimin vendos jashtë seancës gjyqësore konform nenit 73 të LPP-së. Gjykata, ka vlerësuar të gjitha provat dhe faktet si dhe prapësimin e ushtruar nga debitorja, mirëpo në rastin konkret nga shkresat e lëndës ka dal të jenë të pabazuara pretendimet nga prapësimi andaj ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, të cilin përfundim të gjykatës së shkallës së parë e përkrah edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Cap.nr.1328/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti